



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

**“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “BEJKUSH BIRÇE” NË TERRITORIN E
BASHKISË VLORË”**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika II; me propozim të shoqatës “Shkrimtarëve dhe Artistëve” Dega Vlorë, datë 08.07.2024 të miratuar nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë me Vendimin Nr.1 datë 08.07.2024, si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 27.11.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e sheshit “Bejkush Birçe” në lagjen 10 Korriku, Rajoni 2, pranë Stadiumit “Flamurtari”, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55 pika 6.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më ____ . ____ . 2024

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E SHESHIT “BEJKUSH BIRÇE” NË TERRITORIN E
BASHKISË VLORË”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Ju paraqesim për miratim Projektvendimin “Për Miratimin e Sheshit “Bejkush Birçe” në Territorin e Bashkisë Vlorë” i cili është një propozim i shoqatës “Shkrimtarëve dhe Artistëve” Petro Marko Vlorë si dhe shoqata Atdhetare-Kulturore “Bolena” Vlorë. Ky propozim është kërkuar të vlerësohet nga Këshilli i Bashkisë për këtë personalitet të shquar i cili ka dhënë kontribut të spikatur veçanërisht në fushën e sportit. Karriera e tij, si futbollist por veçanërisht si trajnier i disa skuadrave, sidomos si trajnier i ekipit “Flamurtari” të qytetit të Vlorës dhe ekipit kombëtar ka lënë gjurmë në historinë e sportit Shqiptar.

Është për tu theksuar se marrëdhëniet dhe interesimi i tij për qytetin e Vlorës kanë qënë të vazhdueshme gjatë gjithë karrierës së tij sportive.

Për të mos u zgjatur në vlerat që mbart ky personalitet i shquar, bëshkëlidhur këtij projektvendimi mund të gjeni dhe përshkrimin e karrierës së tij në propozimin e bërë nga shoqata “Shkrimtarëve dhe Artistëve “Petro Marko” Vlorë si dhe shoqata Atdhetare-Kulturore “Bolena” Vlorë.

Ky propozim është miratuar edhe nga Komisioni Këshillimor i Titujve Vendorë të Nderit i Këshillit të Bashkisë në datën 08.07.2024, Komision i cili gjithashtu propozon që ky projektvendim të miratohet nga Këshilli i Bashkisë

Nga sa më lartë kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projektvendim, si një vlerësim për këtë personalitet të shquar të qytetit të Vlorë por edhe në rang Kombëtar.

Ju faleminderit

**KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri**